



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
  
Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

## **Diskutim me komunitetin në Mynih**

*Projektiligji për Diasporën dhe Projekt-Strategjia(2019-2023)*

Përmbledhja e rekomandimeve

Mynih, tetor 2018

© 2018 Germin

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Germin ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

**Adresa:** Rr."Tringë Smajli". Nr.48

10000 Prishtinë, Kosovë

**E-mail:** [germinks@gmail.com](mailto:germinks@gmail.com)

**Web:** [www.diasporaflet.org](http://www.diasporaflet.org)

**Autor:** GERMIN

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

## **Mirënjohje**

Germin është shumë mirënjohës ndaj pjesëmarrësve të takimit që kanë gjetur kohën për të qenë pjesë e këtij takimi për të shprehur rekomandimet, sfidat dhe kërkesat e diasporës ndaj projektligjit dhe projekt-strategjisë për Diasporën. Ekipi ynë është gjithashtu shumë mirënjohës ndaj shoqërisë së akademikëve shqiptarë Dijs e. V për mbështetjen e tyre në organizimin e këtij takimi në Mynih të Gjermanisë.

## Qëllimi i Raportit & Metodologjia

Takimi me diasporën shqiptare u organizua në Mynih të Gjermanisë nga Germin, organizatë joqeveritare e përqëndruar në Kosovë me fokus në hulumtime rreth diasporës. Ky takimi ishte pjesë e projektit *Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave*. Qëllimi gjithëpërfshirës i këtij projekti është që të lehtësojë kontributin e Diasporës në Kosovë gjatë procesit të hartimit të politikave dhe strategjive, në veçanti të *Strategjisë për Diasporën (2019 -2023)*, *Planit të Veprimit (2019-2021)* dhe *Projektligjit për Diasporën*.

### Përmes kësaj nisme synohet:

- Të avancohet zëri i Diasporës në hartimin e politikave dhe strategjive me anë të forumeve dhe kanaleve të reja teknologjike;
- Të përfshihen aftësitë dhe njohuritë e pjesëtarëve të Diasporës që proceset gjatë zhvillimit të politikave dhe legjislacionit;
- Të fuqizohen pjesëtarët e shtatë task forcave të krijuara nga Germin për të marrë pjesë në proceset politikëbërëse në Kosovë.

Ky raport paraqet sfidat, kërkesat dhe rekomandimet kryesore të nxjerra nga takimi me anëtarët e diasporës të mbajtur me datën 13 tetor 2018 në Mynih.

Në këtë takim prezent ishin 27 pjesëmarrës (16 burra dhe 11 gra) që përfaqësonin shoqata, organizata dhe biznese të ndryshme në Republikën e Bavarisë. Bashkëbisedimi u organizua në tre pjesë. Në pjesën e parë u diskutua për *Projektligjin për Diasporën*, në pjesën e dytë diskutimi u përqendrua në *Projekt-Strategjinë (2019-2023)*, për të vazhduar pjesën e tretë në *Planin e Veprimit (2019-2021)*. Pjesëmarrësit në këto tri pjesë të takimit patën mundësinë që drejtëpërdrejtë të kalojnë rekomandimet e tyre në këto dokumente ku bëhet fjalë për zbatimin e të drejtave të tyre politike, socio-ekonomike dhe kulturore në vendin e origjinës. Gjuha e përdorur përgjatë takimit ishte gjuha shqipe dhe të gjithë pjesëmarrësit identifikohen si shqiptarë, mirëpo diversiteti i tyre përfaqëson një sërë opinionesh, prespektivash dhe temash të identifikuar në këtë raport. Pjesëmarrësit vinin nga fusha dhe profesione të ndryshme (p.sh. arsim, inxhinieri, studentë, përfaqësues shoqatave kulturore, politikan, përfaqësues biznesesh, etj.) dhe prejardhja e tyre varionte nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit.

### Rekomandimet kryesore të dalura nga takimi në Mynih

Pas shumë diskutimesh në këtë takim dolën këto rekomandime që Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike duhet t'i merr për bazë në përpilimin final të këtyre dokumenteve.

### Qendrat Kulturore

Edhe pse në ligjin aktual [nr.04/L - 095 "Ligji për Diasporën dhe Mërgatën"](#) janë të parapara Qendrat Kulturore në Diasporë, me projektligjin e propozuar këto

qendra do të veprojnë në kuadër të misioneve diplomatike, ndërkohë sipas raportimeve<sup>1</sup> të Ministrisë aktual, Dardan Gashit, 3 qendrat e mëparshme që ishin aktive janë mbyllur. Sipas marrëveshjes me Shqipërinë, do të hapen qendra të reja në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Diasporën.

Kjo pjesë e projektligjit është shumë e paqartë për shumë anëtarë të diasporës. Poashtu shumica prej tyre nuk pajtohen me formën se si ministria ka paraparë funksionimin e tyre. Praktika e kaluar me funksionimin e tre qendrave kulturore në Diasporë, sipas të pranishmëve, dëshmon se Ministria e Diasporës nuk është e aftë të menaxhojë dhe monitorojë 27 sosh.

*“Krijimi i Qendrave Kulturore në Diasporë(QKD) në bashkëpunim me shoqatat/organizatat ekzistuese në diasporë. Institucionet shtetërore nuk duhet të vendosin se ku duhet të hapen QKD, kjo duhet të vendoset prej anëtarëve të diasporës. Modelet më të mira për funksionimin e Qendrave Kulturore janë: Gotte Institute, British Council dhe Qeveria mund të ndjekë shembujt e tyre”.*

*“Diasporës i duhet një qendër në Prishtinë apo Tiranë, që të kemi një derë të hapur atje për kërkesat tona, pastaj të krijohet një fond për ndihmë simbolike për shoqatat ekzistuese në diasporë”.*

*“Me krijimin e Qendrave Kulturore në Diasporë nga ana e Ministrisë, si dhe me zgjedhjet e drejtorit nga Qeveria e Kosovës rrezikojmë që këto qendra të politizohen”.*

Këto ishin disa prej rekomandimeve sa i përket Qendrave Kulturore në Diasporë. Më shumë rekomandime për këtë temë mund t'i gjeni në shtojcën 1.

## **E drejta e votës**

Përfshirja e diasporës në proceset politike, posaçërisht në votim, është e garantuar me ligj, mirëpo pengesat e ndryshme teknike, administrative dhe ligjore vështirësojnë pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale dhe për Kuvendin e Kosovës.. Aktualisht, në Projekt-Strategjinë për Diasporën 2019-2023, nën objektivin strategjike *Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale* është trajtuar pjesëmarrja e Diasporës në zgjedhje, mirëpo kjo pjesë mungon tek Projektligji për Diasporën. Për këtë arsye, të pranishmit rekomandojnë që Projektligji dhe Projekt-Strategjia të harmonizohen dhe të inkuadrohen nënë të cilat synojnë lehtësime e pjesëmarrjes së diasporës gjatë zgjedhjeve në Kosovë.

Votimi i anëtarëve të diasporës nëpër konsulata, votimi on-line, votimi me postë në konsulata, të gjitha këto metoda do të lehtësonin procesin e votimit nga jashtë, u shprehen pjesëmarrësit.

*“Për shkak të numrit të vogël të pjesëmarrjes së Diasporës në zgjedhje, p.sh në vitin 2017 në zgjedhjet nacionale janë pranuar vetëm 5.246 vota valide nga Diaspora - të pranishmit rekomandojnë që institucionet e*

---

<sup>1</sup> Ministri Gashi Raporton Para Komisionit: Problematike Anëtarësimi Në Kartonin e Gjelbër.” *Klan Kosova*, July 2018, [klankosova.tv/ministri-gashi-raporton-para-komisionit-problematike-anetaresimi-ne-kartonin-e-gjelber/](http://klankosova.tv/ministri-gashi-raporton-para-komisionit-problematike-anetaresimi-ne-kartonin-e-gjelber/).

*Kosovës të lansojnë më shumë fushata vetëdijesuese dhe informuese për votim jashtë vendit.”*

## **Përfaqësimi i diasporës**

Roli dhe potenciali i diasporës është duke marrë çdo ditë e më shumë vëmendje nga politikëbërësit, hulumtuesit dhe publiku dhe më shumë hapësirë në strategjitë zhvillimore të vendeve të ndryshme. Krijimi i lidhjeve në mes të pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të vendit të origjinës është një proces që kërkon angazhim dhe përkushtim të veçantë. Mënyra e çasjes ndaj një procesi të tillë është përcaktuese e nivelit të angazhimit dhe përfshirjes së diasporës në institucionet e shtetit dhe proceset tjera shoqërore të vendit të prejardhjes.

Sa i përket kësaj teme shumë anëtarë të diasporës rekomanduan që nuk është e nevojshme të ketë përfaqësim në kuvend nga anëtarët e diasporës sepse një ose disa deputet nuk mund të përfaqësojnë të drejta e diasporës si duhet.

*“Të krijohet një zyrë e veçantë jo-partiake/politike e cila mbron të drejtat e diasporës”.*

*“Për dallim nga përfaqësimi në Kuvend, pjesëmarrësit rekomandojnë që angazhimi i diasporës në institucionet e tjera kyçe do të ndihmonte Kosovën duke sjellë përvojat e vendeve perëndimore dhe kësaj do të dëgjonte kontributin e diasporës ndaj Kosovës”.*

Këto ishin disa prej rekomandimeve sa i përket përfaqësimit të diasporës në vendim-marrje dhe politikëbërje.

## **Transferi i dijes**

Transferi i dijes apo sjellja e trurit të diasporës në vendin e origjinës është një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e shtetit amë. Institucionet tona kanë qenë jo aktive për sa i përket shfrytëzimit të potencialit të diasporës, respektivisht angazhimit të njerëzve të cilët kanë fituar përvoja jashtëzakonisht të mira në vendet ku ata jetojnë. Disa prej pjesëmarrësve në takimin e Mynihut u shprehën:

*“Krijimi i një platforme shtetërore për ekspertët nga diaspora, duke krijuar fillimisht databazën e ekspertëve dhe profesionistëve jashtë vendit. Remitancat të kthehen në investime, të ndërtohen kampuse, shkolla të cilat do të bëjnë transferin e dijes përmes aktiviteteve të ndryshme për të rinjtë nga Kosova dhe Diaspora”.*

*“Të caktohet një kuotë për angazhim të ekspertëve nga diaspora nëpër institucionet publike në Kosovë”.*

## **Sfidat**

Një ndër problemet kryesore të organizimit komunitar në Bavari ishte edhe mungesa e përkrahjes nga misionet diplomatike. Të dëshpëruar nga konsullata në Mynih, ata rekomanduan që personeli në këto misione të jetë nga Diaspora, si dhe të përkrahë dhe informojë komunitetin rreth organizimeve kulturore dhe shkencore në Republikën e Bavarisë.

Poashtu si sfidë shohin edhe angazhimin minimal të organeve shtetërore për avancimin e të drejtave politike e shoqërore të diasporës (e drejta për pjesëmarrje në zgjedhje, e drejta e përfaqësimit etj).

## **Kërkesat**

Përshkak të limiteve buxhetore, mungesës së burimeve njerëzore dhe kompetencave të limituara, të pranishmit rekomanduan që Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në të ardhmen të mbyllet dhe si e tillë të kalohet nën mandatin e Ministrisë së Punëve të Jashtme duke funksionuar sikur një Agjenci. Një tjetër kërkesë nga ky komunitet ishte edhe angazhimi i tyre në diplomacinë kosovare si dhe stafi i misioneve diplomatike të jetë nga Diaspora.

## **SHTOJCAT:**

### **1. Qendrat Kulturore në Diasporë (QKD)**

- Të krijohen Qendrat kulturore në Diasporë (QKD) në bashkëpunim me qendrat/shoqatat/organizatat ekzistuese;
- Të bëhet rrjetëzimi/ri-organizmi i shoqatave aktuale;
- MDIS duhet të krijojë një fondacion që financon shoqatat jashtë vendit të origjinës, ky fondacion të krijohet ose me anëtarësime apo nga donator të ndryshëm;
- Të shfrytëzohen shoqatat ekzistuese në Diasporë si Qendra të Kulturës;
- Institucionet nuk duhet të vendosin se ku duhet hapur QKD sepse mund të ketë diskriminim ndaj organizatave/shoqatave ekzistuese;
- Krijimi i zyrave/qendrave në Tiranë apo Prishtinë, si ndërlidhëse mes vendit të origjinës dhe diasporës;
- Të krijohet një kulm/bashki e shoqatave nën organizimin e vet diasporës;
- Qendrat kulturore të mos politizohen;
- Me krijimin e QKD nga ana e MDIS atëherë do ketë dirigjime të shoqatave, ndërsa shoqatat aktuale nuk pranojnë të jenë të dirigjuara;
- QKD të ketë në vende të mëdha ku mësohet gjuha shqipe, të ketë një librari me libra në gjuhën shqipe;
- Të krijohet një fondacion nga diaspora shqiptare me nje statut. Brenda fondacionit të ketë grupe të caktura si, psh: grupi i rinisë, grave, etj. Të ketë rrjetëzim dhe strukturë institucionale;
- Me krijim të QKD do ketë instalime dhe diktme nga ana e institucioneve përgjegjëse të aktiviteteve të shoqatave aktuale;
- Koordinator/ja i QKD-së nuk duhet të jetë nga Kosova mirëpo të jetë shqiptarë/e nga diaspora;
- QKD duhet të jenë shumë mirë të instaluar me ligjin e Kosovës apo shtetit prej të cilit krijohen, sepse mund të kthehen në qendra elektorale;
- QKD të ketë anëtar të diasporës dhe të jetë qendër informuese;
- QKD duhet të krijohen në formën e Gotte Institute apo edhe instituteve/këshillave të tjera botërore - të cilat janë fondacionë të financuara nga Shteti dhe nga grantet e tjera.



## Rreth Germin

Germin është organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet digjitale për të lidhur dhe angazhuar diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre amë. Ne përpiqemi të eksplorojmë dhe përdorim kanalet e TIK-ut për të lehtësuar më mirë dhe fuqizuar lidhjet mes diasporës, qytetarëve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor. Germin drejtohet nga një grup i profesionistëve të diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informimit dhe teknologjisë, juridikut dhe edukimit, sigurisë dhe mbrojtjes. Germin ka një rrjet prej 150 profesionistësh dhe bashkëpunëtorëve me kohë të pjesshme, që aktualisht jetojnë në 24 shtete përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore. Germin po ashtu ka një rrjet prej 242 organizatave partnere në Diasporë përfshirë Europën, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadanë, Azinë dhe Australinë.

Angazhimi i Diasporës për Zhvillimin e Politikave është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).